



BASHKIA SKRAPAR

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: Mbrojtje lumore në të dy anët e përroit të Malindit, në këmbët e Urës së Malindit, hyrje - dalje, Bashkia Skrapar

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45243510-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 29 519 395 (njëzetë e nëntëmilion e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Skrapar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Për pikën a.- në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26; për pikën b.-në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 83 “Sigurimi i ofertës”, pika 1 dhe 2, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, 2 dhe 3.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo kërkesë konsiderohet e plotësuar, nëse operatori ekonomik ofertues, është kualifikuar për kriteret e përgjithsme të kualifikimit, të përshkruara në pikën 1, sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të dorëzuar prej tij, në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, **duhet të jetë jo më e vogël se 99%, e shprehur në lekë (29,224,201), e vlerës së përlogaritur të fondit limit të objektit të prokurimit.**

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi:

*(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1 dhe pika 2 gërma b), si dhe neni 29, pika 1, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, ku **parashikohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”***

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet financiare (2023, 2024, 2025), që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur **nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Argumentimi:

(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4.)

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “b” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku **parashikohet se:**

“Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre: b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:**

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50(pesëdhjetë) milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi:

(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4.) Njësia e prokurimit e vlerëson te nevojshme kriterin për xhiron mesatare, dorëzimin e dokumentit përkatës vërtetim dhe pasqyrat financiare vjetore, pasi vërtetojnë kapacitetet ekonomike, financiare të operatorit ekonomik me qëllim përmbushjen dhe realizimin e kontratës. Kapaciteti pozitiv financiar i operatorit i dokumentuar me bilance apo pasqyra financiare për tre vite buxhetore i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatoreve ekonomikë në një periudhë të afërt me prokurimin e tanishëm, dhe të mundësisë se tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Pasqyrat financiare me bilanc pozitiv dhe gjendja financiare bankare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar të operatorit ekonomik.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e vitit 2025 dhe ato të maturuara për vitin 2026.

Shënim : *Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet për vitin 2025 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2026 (në seksion të veçantë nga taksat dhe detyrimet tatimore në formularin e deklarimit nr.8).*

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi:

(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Njësia e prokurimit e vlerëson të nevojshëm vendosjen e këtij kriteri, pasi tregon që operatorët ekonomikë i kanë paguar të gjitha detyrimet e taksave për kryerjen e aktivitetit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;)

2.3 Kapaciteti teknik

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë, duhet të garantojnë që zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme, për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie, duke përmbushur kërkesat si më poshtë:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **48%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **59,000,000** (pesëdhjetë e nëntë milion) lekë.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, **kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik**, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen **vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë**, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, si dhe:

- Situacionin përfundimtar të punimeve (për të vërtetuar natyrën e punës së kryer)

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi, **vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës**, ku të shënohen **vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë**, e shoqëruar me **fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore**, si dhe:

- Situacionin përfundimtar të punimeve (për të vërtetuar natyrën e punës së kryer)

2.3.1.1 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar, për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

2.3.1.2 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, pika 2.3.1 gërma a), plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Argumentimi:

((Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5, dhe neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” pika 3, si dhe për të përcaktuar saktë natyrën e punimeve të ngjashme të realizuara me sukses)

2.4 Licenca profesionale

Operatori ekonomik ofertues, duhet të zotërojë licencë profesionale në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, e cila të përmbajë kategoritë si më poshtë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P. – 1 A: Punime gjërmimi në tokë.

N.P. – 9 B: Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

N.S. – 18 B: Punime topogjeodezike

Argumentimi:

(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 gërma a), VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, si dhe në përputhje me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve si dhe grafikun e detajuar të punimeve me kohët e punës, numrin e punonjësve, numrin e specialistëve, numrin e drejtuesve teknikë, licencat e nevojshme dhe makineritë dhe paisjet, të hartuar nga specialisti i fushës në njësinë e prokurimit. Argumentimi i licencave përshkruhet në tabelën e mëposhtme):

Analiza	Argumentimit i analizës sipas VKM.42	Niveli i shoqërisë	Zërat e punës në preventiv
N.P.-1	Konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore.	A: Vlera e punimeve të gjërmimit dhe mbushjeve 0-20 milion	Sipas punimeve të përshkruara në preventiv: Gërmim shkëmbi i coptuar me ekskavator 0.5 m³, shkëmb, prani uji ~2m, themele gjerësi >2 m, me shkarkim ne toke.; Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m³, ne kanale gjerësi deri 2 m, prani uji ~ 2m

			kategoria IV, me shk ne toke per devijim lumi (2here); Mbushje me zhavorr pas mureve
N.P.-9	Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, sido që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra , të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme , sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafragmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.	B: Vlera e punimeve 21-50 milion (të gjitha punimet konsiderohen mbrojtje lumore)	Sipas emërimit të objektit: " Mbrojtje Lumore në të dy anët e përroit të Malindit në këmbët e Urës së Malindit Hyrje+Dalje, Bashkia SKRAPAR "
N.S.-18	<i>Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.</i>	B: Të gjitha punimet, përveç punimeve për devijimin e lumit, kanë vleren 21 - 50 milion	Për drejtimimin e punimeve, topogjeodezike në veprat inxhinierike.

2.5 Stafi dhe punonjësit

2.5.1 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar drejtuesit teknik, që kanë në licencën e shoqërisë, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit (Mars 2026) nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- Inxhinier hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier gjeodet 1 (një)

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, **sipas shtojcës nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqitet:

- *Të figurojë si komponent i listës së drejtuesve teknik në licencën e subjektit*
- *Licencën personale profesionale.(nëse ka)/ kopjen e diplomës*
- *Drejtuesit teknik të jenë të siguar sipas legjislacionit në fuqi, në listëpagesat e muajit të fundit që është kërkuar më poshtë.*

2.5.2 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar punonjës të kualifikuar në profesionet si më poshtë:

A. Specialistë ndërtimi

– Teknik Ndërtimi	1 (një)
– Topograf	1 (një)
– Specialistë betoni etj.	4 (katër)
– Hekurthyes	2 (dy)
– Punues guri dhe muratorë	6 (gjashtë)
– Karpentierë	2 (dy)
– Punonjës të tjerë (punëtorë)	30 (tridhjetë)

B. Drejtues të makinerive të rënda të ndërtimit dhe drejtues kamioni

– Eskavatorist	2 (dy)
– Drejtues kamioni me Leje drejtimi të tipi C	2 (dy)

Për specialistët e kërkuar më sipër (pika 2.5.2 gërma A) të paraqiten:

- diplomë/ dëshmi/ certifikatë/ ose çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimin e tyre
- kontrata e punës, e vlefshme për të paktën, periudhën e parashikuar të realizimit të punimeve
- të figurojnë në listepagesat e shoqërisë, të paktën, për **muajin e fundit (Prill 2026)** nga data e hapjes së ofertave.

Për drejtues të makinerive të rënda të ndërtimit dhe drejtues kamioni (pika 2.5.2 gërma B), të kërkuar më sipër të paraqiten:

- kontrata e punës, e vlefshme për të paktën, periudhën e parashikuar të realizimit të punimeve;
 - Certifikatë Aftësimi Profesional për Përdoruesit e Makinerive të Rënda të Ndërtimit dhe Punimeve në Tokë nga DPSHTRR; (për eskavatoristin)
 - Certifikatë Aftësimi Profesional për Automjete për përdorim të veçantë (APV) nga DPSHTRR (për automakinistin).
 - Leje Drejtimi kategoria C me Certifikatë Aftësimi Profesional nga DPSHTRR (për drejtues kamioni);
 - të figurojnë në listepagesat e shoqërisë të paktën për **muajin e fundit (Prill 2026)**, nga data e hapjes së ofertave. **Shënim:** Kjo kërkesë nuk është e detyrueshme **për drejtuesit e mjeteve me qera**. Në këtë rast, disponimi i drejtuesve të mjeteve, mund të jetë nëpërmjet llojeve të ndryshme që parashikohen nga legjislacioni që rregullon fushën konkrete, **me kushtin që** subjekti të respektojë kërkesat e Autoritetit Kontraktor, në Njoftimin e Kontratës, në lidhje me **“Nënkontraktimin”** dhe **“Mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera”**.
-

2.5.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar një numër, të paktën, prej **52 (pesëdhjetë e dy)** punonjësish, **përveç stafit drejtues menaxherial**, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për **muajin e fundit (Prill 2026)** nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e deklaruar.

Argumentimi:

(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, pika 6 gërma c) dhe ç), Ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM-së nr.153 datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, si dhe në përputhje me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve si dhe grafikun e detajuar të punimeve me kohët e punës, numrin e punonjësve, numrin e specialistëve, numrin e drejtuesve teknikë, licencat e nevojshme dhe makineritë dhe paisjet, të hartuar nga specialisti i fushës në njësinë e prokurimit).

Argumentimi për pikën 2.5.1:

STAFI DREJTUES TEKNIK (në licencën e subjektit)	Argumentimi
Inxhinier hidroteknik	Sipas kërkesës së licencës NP-9 për subjektin. Për drejtimin e punimeve të mbrojtjes hidroteknike
Inxhinier gjeodet	Sipas kërkesës së licencës NS18 për subjektin. Për punimet topogjeodezike në objekte inxhinierike

Argumentimi për pikën 2.5.2 gëma A:

SPECIALISTET E NDERTIMIT	Argumentimi
Teknik ndërtimi	Për ndjekjen e punimeve në përgjithësi.
Topograf	Për drejtimet dhe kuotat e mbrojtjes me gabiona dhe me mur betoni. Punime topogjeodezike në veprat inxhinierike.
Specialist betoni etj.	Për zërin e punimeve " Shtrese e varfer betoni per themelin e murit betonarme C12/15; Mur betoni+themel C20/25 per mbrojtjen; Veshje me beton e themelit te gabionave C20/25 "
Hekurthyes	Për zërin e punimeve " F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 12mm per murin e betonit dhe veshjen e themelit te gabionave "
Punues guri dhe muratorë	Për zërin e punimeve "Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 2x1x1m" dhe " ...2x1x1.5".
Karponenterë	Për ndërtimin e kallëpeve dhe armaturës së mureve të betonit
Punonjës të tjerë (punëtorë)	Janë parashikuar 9 punëtorë dhe 6 specialist në zërin: Mur betoni+themel C20/25 per mbrojtjen;dhe 21 punëtorë dhe 6 specialistë në zërin: "Gabiona me rrjete teli te zing, gure kave ...". Këta janë zërat që përbëjnë dhe numrin më të madh të punonjësve dhe që realizohen njëkohësisht

Argumentimi për pikën 2.5.2 gëma B:

DREJTUES TË MAKINERIVE TË RËNDA TË NDËRTIMIT DHE DREJTUES KAMIONI	Argumentimi
---	-------------

ESKAVATORIST (i paisur me Certifikatë Aftësimi Profesional për Përdoruesit e Makinerive të Rënda të Ndërtimit dhe Punimeve në Tokë nga DPSHTRR.)	Për punimet sipas zërave të preventivit "Germim shkëmbi i coptuar me ekskavator 0.5 m ³ , shkëmb, prani uji ~2m, themele gjerësi >2 m, me shkarkim në toke; Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m ³ , në kanale gjerësi deri 2 m, prani uji ~ 2m kategoria IV, me shk në toke për devijim lumi (2here)"
Drejtues kamioni me Leje drejtimi të tipi C si dhe të pajisur me Certifikatë Aftësimi Profesional nga DPSHTRR	Për drejtimin e kamionëve vetshkarkues 10m ³ si dhe për autobotin e ujit.
shënim: pavarësisht se numri i mjeteve është më i madh se numri i drejtuesve të tyre, në llogaritje është marë parasysh që njëri nga drejtuesit e kamionëve vetshkarkues 10m ³ , mund të jetë dhe drejtues për autobotin e ujit, njëri nga eskavatoristët drejton njëkohësisht edhe fadromën, pa prishur radhën e punimeve. Gjithashtu transporti i eskavatorëve mund të realizohet përpara datës së fillimit të punimeve. (Numri i mësipërm është numri minimal i kërkuar).	

Argumentimi për pikën 2.5.3

Në grafikun e detajuar të punimeve, të hartuar nga specialisti i fushës në njësinë e prokurimit, janë përcaktuar normat e kohës së punës për çdo zë punimi, nga të cilat rezulton që për një afat prej 90 ditësh kalendarike (aq sa është dhe afati i përcaktuar në grafikun e hartuar nga projektuesi), nevojiten **52 (pesëdhjetë e dy)** punonjës, pa përfshirë stafin manaxherial të subjektit.

2.5.4 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar punonjës të kualifikuar/certifikuar, si dhe të figurojnë në listpagesa për muajin e fundit, **(Prill 2026)** si më poshtë:

- 1 (një) nga punonjësit, të disponojnë certifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.
- 1 (një) nga punonjësit, jetë i pajisur me certifikatë të lëshuar nga një organ i akredituar për dhënien e Ndhmës së Parë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

-Argumentimi:

Në mbështetje të ligjit Nr.10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe VKM-në Nr.312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier”, si dhe Nr.108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar.

2.6 Mjetet dhe paisjet.

2.6.1 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë mjetet dhe paisjet e nevojshme për realizimin në kohë dhe me sukses të punimeve, si më poshtë:

	Paisje e makineri	Njësia	Sasia	Pronësia
1	Ekskavator me zinxhirë me kove 0.5m ³	copë	2	Në pronësi ose me qera
2	Rimorkjator (kamion të përshtatshëm për transportin e	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Betoniere kantieri 550l / (ose autobetoniere kantieri	copë	3 / (1)	Në pronësi ose me qera

4	Vibrator betoni	copë	2	Në pronësi ose me qera
5	Autobot	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Motopompë me karburant	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Kamione vetshkakues me kapacitet (10m ³)	copë	2	Në pronësi ose me qera
8	Fadromë	copë	1	Në pronësi ose me qera

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, **sipas shtojcës nr. 8.** *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese”,* si më poshtë:

- (a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:
- dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit, (çertifikata e pronësisë);
 - dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit);
 - çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
 - siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
 - leje transporti e vlefshme nga njësi vendore (sipas rastit)
 - foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij;
- (b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe:
- kontrata e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- (c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:
- kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse
 - fotot
- (d) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë kur janë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet:
- kontrata e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Shënim:

Në rastin kur fatura tatimore është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së, ajo duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi:

(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 gërma d), si dhe në përputhje me zërat dhe afatin e punimeve të parashikuara në preventivin si dhe grafikun e detajuar të punimeve me kohët e punës, numrin e punonjësve, numrin e specialistëve, numrin e drejtuesve teknikë, licencat e nevojshme dhe makineritë dhe paisjet, të hartuar nga specialisti i fushës në njësinë e prokurimit), në tabelën më poshtë argumentohet nevoja për paisjet dhe makineritë.

Paisje e makineri	Njësi	Sasi	Zërat e punës në preventiv
Ekskavator me zinxhirë me kove 0.5m ³	copë	2	"Germim shkambi i coptuar me ekskavator 0.5 m ³ , shkemb, prani uji ~2m, themele gjeresi >2 m, me shkarkim ne toke"; "Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji ~ 2m kategoria IV, me shk ne toke per devijim lumi (2here)"
Rimorkjator (kamion të përshtatshëm për transportin e eskavatorëve)	copë	1	Për transportin e eskavatorëve
Betoniere kantieri 550l / (ose autobetoniere kantieri vetngarkuese)	copë	3 / (1)	"Shtrese e varfer betoni per themelin e murit betonarme C12/15"; "Mur betoni+themel C20/25 per mbrojtjen"; "Veshje me beton e themelit te gabionave C20/25"
Vibrator betoni	copë	2	
Autobot	copë	1	
Motopompë me karburant	copë	1	Për largimin e ujit nga themeli
Kamione vetshkakues me kapacitet (10m ³)	copë	2	Transport materiale ndertimi, deri 50.0 km;
Fadromë	copë	1	"Mbushje me zhavorr pas mureve" si dhe për afrimin e gurëve për ndërtimin e mbrojtjes me gabiona

3. TË PËRGJITHSHME

Pavarësisht sa përcaktohet në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit”, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe të paraqitura nga ofertuesi në formularin përmbledhës të deklaramentit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

A. MIRATIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti i prokurimit “Mbrotjtje Lumore në të dy anët e përroit të Malindit në këmbët e Urës së Malindit Hyrje+Dalje, Bashkia SKRAPAR”, shoqërohet me projekt zbatimimi të plotë, preventiv e punimesh, specifikimet teknike, grafik punimesh dhe relacionin Teknik, të hartuar nga “2H STUDIO” sh.p.k..

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Skrapar, ka miratuar projektin e hartuar nga “2H STUDIO” sh.p.k, për rrjedhojë edhe **Specifikimet Teknike**.

Për pasojë, kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 36 “Specifikimet teknike”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 neni 2 “Dokumentimi i Procesit”, pika 2 gërma c), dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, lidhur me hartimin e specifikimeve teknike, konsiderohet e realizuar, pasi specifikimet janë hartuar dhe miratuar paraprakisht.

Specifikimet teknike, të miratuara edhe nga njësia e prokurimit, do të jepen bashkëlidhur Dokumenteve Standarte të Tenderit, për procedurën e hapur punë.

B. Përfundime

Me miratimin e kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, kriterëve të vlerësimit, si dhe specifikimeve teknike, njësia e Prokurimit miraton Dokumentet Standarte të Tenderit, për procedurën e hapur punë, me objekt prokurimi ***“Mbrojtje Lumore në të dy anët e përroit të Malindit në këmbët e Urës së Malindit Hyrje+Dalje, Bashkia SKRAPAR”***. Personi përgjegjës i prokurimit, pjesë e njësisë së prokurimit, të bëjë publikimin e procedurës në Sistemin e prokurimit elektronik, në faqen e APP-së.

NJËSIA E PROKURIMIT

Altin Lamçe

Benis Dosti

Florand Omani
